



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 03.03.2022 të parashtruar nga OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan” me nr. të Prokurimit 613 022 016 521

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj të dt.03.03.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan” me nr. të Prokurimit 613 022 016 521

Vërtetohet Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të publikuara në platformën e prokurimit të datës: 22.02.2022.

1. **Mbetet në fuqi** Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të datës: 22.02.2022.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

OE N.P.SH BAGERI nga Ferizaj ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan" me nr. të Prokurimit 613 022 016 521. Lidhur me kushtet e pjesëmarrjes të parashtrura nga AK.

Pretendimi juaj i parë dhe i dytë:

b. Çertifikate ENEC të cilësise si dhe çertifikaten për mbrojtje IP (për lamp dhe dioda)
Kerkojme që ky kriter të largohet nga DT pasi që me këto Iso duhet të jenë të paisur prodhuesit e llampave dhe diodave dhe jo në si OE Ofertues dhe Montues të këtyre llampave dhe diodave.

Ju si AK dhe mbykqyres të punimeve të mundeshme mundeni gjat realizimit të punimeve të kerkoni që furnizuesi i këtyre të jetë i qertifikuar dhe jo të kerkoni nga Ofertuesi Ndërtimtare të jetë i paisur për të ofertuar.

Eskavator max 1 T

Kerkojme që ky kriter të ndryshohet dhe të bëhet min 1 ton pasi që si e tillë nuk ka kuptim pasi që nuk është në rregull që nëse një ofertues posedon një eskavator me peshe 1.2 ton apo 1.5 tone të mos mundet me ofertë pasi që kërkesa është max 1 ton.

Andaj kerkojme nga AK, KK Lipjan përkatësisht nga Zyra e Prokurimit që të bëjë këto ndryshime të domosdoshme dhe të na mundësohet ofertimi të gjithëve pa dallime apo selektime sipas afateve të përcaktuara në LPP në të kundërtën nëse do të vazhdojmë ta kerkojmë të drejtën tone edhe në instanca më të larta përkatësisht në KRPP, OSHP

Sqarim për pretendimin tuaj të parë dhe të dytë:

AK. Drejtoria e prokurimit ka zhvilluar procedurë për projektin me titull: "Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan" dhe nr. të Prokurimit 613 022 016 521.

AK gjatë zhvillimit të procedurave përkushtet për pjesëmarrje të vendos duke u bazuar në rendesinë e projektit dhe nenin 7 të LPP, dhe në asnjë rast AK nuk vendos kritere diskriminuese për OE. Këto kërkesa janë të bazuara në projektin (paramasën) në fjalë.

Sqarim shtesë: AK të Kapaciteti teknik dhe profesional dekëshmia 3 ka cituar shikë përshkrimin (Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate të nënshkruar dhe vëlosur nga të dyja palët). Qdo OE që nuk mund të arrijë vetëm kushtet për pjesëmarrje ai mund të huazoj mjetet e punës apo edhe të aplikoj në Grup të përbashkët të operatorëve ekonomik.


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtori i Prokurimit